

PARASHTRIME TË INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

në çështjen me nr. 28 (E) Regj.Them

I. ÇËSHTJE THELBËSORE

1. Si duhet të jenë Kushtetuta dhe ligji, që pretendimet e kërkuarit të quhen të ligjshme?

Sipas përfytyrimit të kërkuarit	Siç janë në FUQI dhe janë ZBATUAR
Neni 115 i Kushtetutës 1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndalet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. 2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet. 3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.	Neni 115 i Kushtetutës 1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndalet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. 2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet. 3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

Sipas përfytyrimit të kërkuarit	Siç janë në FUQI dhe janë ZBATUAR
Neni 62 i ligjit nr. 139/2015 Shkarkimi i kryetarit të bashkisë Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur: a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve; b) (kërkuari e quan këtë dispozitë antikushtetuese); c) (kërkuari e quan këtë dispozitë antikushtetuese).	Neni 62 i ligjit nr. 139/2015 Shkarkimi i kryetarit të bashkisë Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur: a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve; b) dënohet për kryerjen e një veprë penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata; c) propozohet për shkarkim nga Këshilli Bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

2. Dispozita e nenit 115 të Kushtetutës dhe ajo e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 nuk janë kopje të njëra-tjetrës.

Neni 115 i Kushtetutës nuk përcakton shkaqet për të cilat mund të bëhet shkarkimi i Kryetarit të Bashkisë.

Shkaqet e shkarkimit janë më shumë se një dhe përcaktohen nga ligji, (neni 62 i ligjit nr. 139/2015, por jo vetëm).

Neni 115 i Kushtetutës nuk përcakton organin kompetent për shkarkimin e kryetarit të bashkisë.

Organet kompetente për shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë janë më shumë se një dhe përcaktohen nga ligji, (neni 62 i ligjit nr. 139/2015, por jo vetëm).

Neni 115 i Kushtetutës nuk përcakton procedurën që ndiqet në rastin e shkarkimit të Kryetarit të Bashkisë.

Procedura e shkarkimit përcaktohet nga ligji, (nenet 61 dhe 62 të ligjit nr. 139/2015, por jo vetëm).

Neni 115 i Kushtetutës përcakton garancitë kushtetuese në rastin kur Këshilli i Ministrave ndërmerr shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë “**për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve**”.

Kur Këshilli i Ministrave shkarkon Kryetarin e Bashkisë për këtë shkak, përjashtimisht nga rregullat e veta bazë, Gjykata Kushtetuese merr kompetencën për shqyrtimin e këtij Akti Administrativ Individual. Po kështu, përjashtimisht nga rregullat e përgjithshme që qeverisin mjetet ligjore të mbrojtjes gjyqësore, ky akt administrativ individual pezullohet deri në përfundim të shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Në të gjitha rastet e tjera të shkarkimit, Gjykata Kushtetuese nuk mund të ketë kompetencë, dhe akti nuk mund të pezullohet, sepse del jashtë përcaktimit të pikës 1 të nenit 115 të Kushtetutës, e cila është dega ku varen pika 2 dhe pika 3 e këtij neni. Pa ekzistencën e rrethanave sipas pikës 1, nuk mund të ekzistojnë garancitë sipas pikës 2 apo 3 të këtij neni.

3. Baza ligjore e një akti përcaktohet nga organi që e nxjerr aktin, jo nga pala të cilës i drejtohet ai.

Këshilli Bashkiak Tiranë ka marrë vendimin nr. 69, datë 23.9.2025, “Për propozimin për shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”, bazuar në nenin 61, shkronja “ç”, dhe nenin 62, shkronja “c” të ligjit nr. 139/2015.

Kërkesa e këshilltarëve për shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë, (shkresa nr. 31879 Prot., datë 18.9.2025), është bazuar në shkronjën “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015.

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale të Këshillit Bashkiak Tiranë, i datës 23.9.2025, qartëson se procedura e shkarkimit do të ecte përpara vetëm për këtë shkak ligjor.

Propozimet për përfshirjen në projektvendim të shkaqeve të tjera ligjore nuk u morën parasysh.

Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Tiranë, i datës 23.9.2025, qartëson se shkarkimi është bërë vetëm për shkakun ligjor të përcaktuar nga shkronja “c” e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015.

Kërkesa që të propozohet shkarkimi “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve” është refuzuar në mënyrë eksplicite.

Këshilli i Ministrave ka marrë vendimin nr. 539, datë 25.9.2025, “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj”, bazuar në nenin 62, shkronja “c” e ligjit nr. 139/2015.

Të gjitha këto prova shpresore kanë qenë në dispozicion të Gjykatës Kushtetuese kur vendosi pranimin e një kërkeje që pretendonte se shkarkimi ishte *de facto* shkarkim sipas nenit 115 të Kushtetutës (!!!), ose se nuk mund të ketë shkarkim përveçse sipas nenit 115 të Kushtetutës (!!!).

Nuk ka asnjë shpjegim logjik dhe të arsyeshëm që të bindë palët e përfshira për faktin pse Gjykata Kushtetuese ka injoruar tërësisht aktet zyrtare të disa organeve shtetërore dhe qëndrimin e tyre të qartë se shkarkimi nuk bëhet në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, por në bazë të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 dhe ka nxituar të marrë përsipër

kompetencën, pa analizuar bazën ligjore të shkarkimit dhe pa e dokumentuar këtë analizë. Vendimi i mbledhjes së gjyqtarëve nuk ka asnjë fjalë të vetme për legjitimitimin, kur pranimi për shqyrtim ka vetëm këtë lëndë dhe pezullimi i dekretit nuk mund të jepet nga një organ që nuk është kompetent për çështjen.

4. Gjykata Kushtetuese mund të japë vendim të drejtë e të paanshëm vetëm nëse mban qëndrim neutral ndaj pretendimeve të palëve dhe i shqyrton ato pa paragjytime.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e datës 9.10.2025, ka marrë në konsideratë vetëm pretendimet e paraqitura nga kërkuesi. Palët e interesuara janë privuar me vetëdije nga përfshirja në shqyrtimin e lëndës.

Nuk ka asnjë shpjegim, për shembull, pse nuk i është kërkuar Këshillit të Ministrave që të vinte në dispozicion praktikën shoqëruese të vendimit nr. 539, datë 25.9.2025, minimalisht relacionin shoqërues të projekt-VKM-së dhe procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave. Këto dokumente janë thelbësore për të arritur në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse përmbajnë gjithë arsyetimin ligjor të organit shtetëror rreth kompetencës, analizës ligjore, procedurës dhe mjeteve të ankimit për rastin në fjalë.

Presidenti i Republikës ka patur një arsyetim të shprehur rreth çështjes së kompetencës së Gjykatës Kushtetuese në raport me VKM-në nr. 539, datë 25.9.2025, (njoftimi për media i datës 1.10.2025). Ky arsyetim nuk është marrë fare në konsideratë nga mbledhja e gjyqtarëve, sepse përndryshe rreth tij duhet të kishte një arsyetim në vendim.

Një izolim kaq flagrant ndaj qëndrimit të institucioneve të shtetit për çështjen thelbësore të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese nuk shpjegohet dot me arsye që pranohen nga logjika.

5. Gjykata Kushtetuese është organ i lartë shtetëror, i cili nuk përjashtohet nga zbatimi i parimit të bashkëpunimit institucional.

Gjykata Kushtetuese është sovrane në gjykimin e saj, por nuk vepron jashtë kohës dhe hapësirës që na rrethon. Që kur nisi procedura për shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, diskutimi i parë thelbësor në publik ka qenë diskutimi për kompetencën në shqyrtimin e mjeteve ligjore.

Ka dy qëndrime të prera lidhur me këtë çështje:

Qëndrimi i parë është ai i kërkuesit, i cili pretendon se kompetenca i takon vetëm Gjykatës Kushtetuese, për shkak të nenit 115 të Kushtetutës.

Qëndrimi i dytë është ai i palëve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës, të cilët kanë bërë të qartë se shkarkimi nuk bëhet për shkakun kushtetues të nenit 115, por për shkakun ligjor të shkronjës “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015. Ky shkak ligjor e kalon kompetencën te Gjykata Administrative. Gjykata Kushtetuese mund

të bëhet kompetente për shqyrtimin e çështjes vetëm në kuadër të gjykimit incidental, kur vihet në lëvizje nga Gjykata Administrative.

Pretendimi i palëve të interesuara gjen mbështetje absolute nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Është kjo e fundit që në vendimin rreth kërkesës së një kryetari tjetër bashkie të shkarkuar, (vendimi nr. 24, datë 23.3.2017), është shprehur se: *“Bazuar në nenet 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individ i mund t’i drejtohet kësaj Gjykate me anë të një ankimi individual, nëse pretendon se gjatë shqyrtimit gjyqësor i janë cenuar të drejtat e tij themelore që burojnë nga Kushtetuta, vetëm pas shterimit të këtyre mjeteve. Individi, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (shih vendimet nr. 52, datë 20.7.2015; nr.85, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese)”*.

Është e qartë që palët e interesuara nuk mund të marrin në konsideratë pezullimin sipas pikës 2 të nenit 115 të Kushtetutës, për sa kohë që ato nuk e shohin nenin 115 të Kushtetutës të lidhur me rastin në fjalë.

Gjykata Kushtetuese është e lirë të përqafojë si pozicionin e kërkuarit, ashtu dhe pozicionin e institucioneve. Sikurse parashtruam më sipër, ajo është sovranë në gjykimin e saj, por nëse përqafton pozicionin e kërkuarit, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të ndërhyjë me vendim pezullimi për VKM-në nr. 539, datë 29.9.2025, nëse vlerëson se:

- a) është vetë kompetente për rastin dhe,
- b) në rastin konkret, ajo vetë çmon se ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577/2000”.

Jo vetëm kërkesa e depozituar, por edhe parimi i bashkëpunimit institucional e obligojnë që këtë ndërhyrje ta bëjë menjëherë, sapo i vihet në dispozicion kërkesa.

Gjykata Kushtetuese nuk mund të injorojë faktin se Presidenti i Republikës ka në dispozicion vetëm 48 orë për shpalljen e datës së zgjedhjeve, se ai nuk e ka opsionin të mos i zbatojë dispozitat ligjore në fuqi e t’i konsiderojë ato antikushtetuese, (sikurse bën ankuesi në kërkesën drejtuar gjykatës), sikurse nuk mund të parashikojë që Gjykata Kushtetuese në këtë rast do të ndihet kompetente, pavarësisht se ligji kompetencën për aktin ia njeh Gjykatës Administrative.

Gjykatës Kushtetuese i ndalohet kategorikisht nga Kushtetuta që me aktet e veta të krijojë konflikte, të destabilizojë rendin kushtetues apo të minojë ushtrimin e ligjshëm të kompetencave nga ana e organeve të tjera kushtetuese. Ndërhyrja në kohën e duhur, në përputhje të plotë me vullnetin e saj, por pa ngritur kurthe ndaj Presidentit dhe organeve të tjera, është përgjegjshmëri kushtetuese. Në këtë rast, kjo përgjegjshmëri i ka munguar

kësaj gjykate në mënyrë flagrante. Motivi që e ka shtyrë Gjykatën në këtë sjellje është i pashpjegueshëm me arsye që pranohen nga logjika.

6. Organi gjyqësor që nuk është kompetent për shqyrtimin e një akti administrativ nuk mund të vendosë pezullimin e aktit.

Dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 350, datë 1.10.2025, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, është akt administrativ.

Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të shqyrtojë kërkesa lidhur me aktet administrative, përveç kërkesave të organeve të zgjedhura drejtpërdrejt të njësive qeverisëse vendore, të cilat shpërndahen ose shkarkohen nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Edhe vendimet e Këshillit të Ministrave për këto raste janë akte administrative, por Kushtetuta ka bërë këtë përjashtim, sepse kërkon që verifikimin e shkakut për shkarkimin, shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, t’ia nënshtrojë gjykimin të lartë të kësaj trupe dhe askujt tjetër.

Duke pranuar kompetencën për gjykimin e një kërkesë kundër dekretit të Presidentit të Republikës, Gjykata Kushtetuese ka kapërcyer kufijtë e kompetencave që i njeh Kushtetuta. Nëse do të ishte organ administrativ, vendimi i saj do të kishte qenë absolutisht i pavlefshëm.

Marrja e vendimeve të ndërmjetme, pezullim i aktit për një çështje që nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese, i vë organet zbatuese përpara një dileme të rëndë kushtetuese: të pranojnë një vendim antikushtetues të Gjykatës Kushtetuese, apo të ushtrojnë arbitraritet dhe të refuzojnë zbatimin. Mjete ligjore kundër vendimeve antikushtetuese të Gjykatës Kushtetuese, siç dihet, nuk ka.

Presidenti i Republikës nuk vendoset përpara kësaj dileme, sepse nuk është organ zbatues i dekretit të vet. KQZ-ja po. Gjithsesi, shqetësimi nuk mund të lihet pa u evidentuar.

Nuk ka asnjë shpjegim të arsyeshëm e të logjikshëm për faktin pse Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur sot e kësaj dite pezullimin e VKM-së nr. 539, datë 25.9.2025, për të cilin vlerësonte se është kompetente, por ka vendosur pezullimin e një akti të Presidentit të Republikës që rrjedh nga VKM-ja nr. 539, datë 25.9.2025, për të cilin qartazi nuk ka asnjë kompetencë.

Pezullimi i VKM-së nr. 539, datë 25.9.2025, do ta linte pa objekt dekretin nr. 350, datë 1.10.2025, sepse nuk mund të zhvillohen zgjedhje aty ku nuk ka vakancë. Vakancën e krijonte vetëm akti i pezulluar (po të pezullohej).

Pezullimi i VKM-së nr. 539, datë 25.9.2025, do të vendoste Presidentin e Republikës përpara detyrimit për të anuluar pikën përkatëse të dekretit nr. 350, datë 1.10.2025, sikurse i takon në zbatim të kompetencës që i ngarkon neni 113 i Kodit të Procedurave Administrative, (ligji nr. 44/2015).

Gjykata Kushtetuese ka tërhequr në shqyrtim një akt për të cilin nuk ka kompetencë, vetëm për të vendosur pezullimin e tij, kur efektin e dëshiruar ligjor mund ta realizonte duke pezulluar aktin primar, për të cilin ndihej kompetente. Ky është veprim haptazi antikushtetues.

Me këtë ndërhyrje antikushtetuese, Gjykata Kushtetuese jo vetëm ka zbuluar edhe një herë anësinë dhe paragjykimin që e ka udhëhequr në shqyrtimin e kësaj çështjeje, por edhe ka penguar Presidentin e Republikës nga ushtrimi i kompetencave të veta ligjore. Ndërhyrja në sferën e kompetencave të një organi tjetër kushtetues është, gjithashtu, një shkelje e rëndë kushtetuese, e cila, gjithashtu, nuk shpjegohet dot me arsye që pranohen nga logjika.

7. Nëse Gjykata Kushtetuese do të pranojë arsyetimin e kërkuarit për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese dhe për interpretimin e nenit 115 të Kushtetutës, atëherë Gjykata do të duhet të arsyetojë një vendim që do të rishkruajë si Kushtetutën, ashtu dhe ligjin nr. 139/2015.

Kërkuarisi, sa herë që i referohet kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, e përshkruan atë si kompetencë për të shqyrtuar ankimin e Kryetarit të shkarkuar të Bashkisë ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave. Ky lexim është haptazi i paplotë. Paragrafi i parë i nenit 115 të Kushtetutës, i lexuar i plotë, bën fjalë për kompetencën për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Ministrave që shkarkojnë Kryetarin e Bashkisë **“për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”**.

Leximi i shkronjave “b” dhe “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 si forma të specifikuar (zbrëthime) të termit **“shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”** që përmban pika 1 e nenit 115 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 bie në kundërshtim të hapur me rregullat në fuqi për interpretimin e normës juridike. Neni 62 i ligjit nr. 139/2015 është dispozitë numerative. Ajo ka listuar tri shkaqe të veçanta të shkarkimit, të cilat nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën. Leximi i kundërt mund të bëhet vetëm nëse dispozita do të kishte këtë përmbajtje:

“Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve edhe rastet kur kryetari i bashkisë:

- a) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata;*
- b) propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë”.*

Leximi që i konsideron shkronjat “b” dhe “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 antikushtetuese, për pasojë të pazbatueshme, është lexim voluntarist i palejueshëm. Asnjë organ shtetëror, subjekt privat apo individ, kur vihet përpara ligjit, nuk ka autoritetin të ndajë çfarë është kushtetuese dhe çfarë nuk është e tillë. Deklarimi antikushtetues i normave juridike në fuqi mund të bëhet vetëm nga Gjykata Kushtetuese dhe vetëm në

kuadër të procedurës së posaçme të parashikuar nga shkronja “a” e nenit 131 të Kushtetutës. Kërkuesi e ka formuluar këtë pretendim si “argument” dhe jo si “kërkesë”. Nëse Gjykata Kushtetuese e pranon atë si “kërkesë”, shkel drejtpërdrejt nenin 131 të Kushtetutës; nëse e pranon si “argument”, modifikon dispozitën e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 në procedurë të parregullt dhe të kundërligjshme shqyrtimi. E ka kurajën Gjykata Kushtetuese ta bëjë një shkelje të tillë? Apo për sa kohë që nuk ka mjete ligjore mbrojtëse ndaj antikushtetutshmërisë së akteve të saj, ajo është e lirë të bëjë ç’të dojë?

8. Gjykata Kushtetuese ka detyrimin të respektojë jurisprudencën e saj.

Parimi kushtetues i sigurisë juridike, i cili është mbrojtur me forcë nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, kërkon prej kësaj gjykate që të konsolidojë praktikën e saj vendimmarrëse. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta lexojë Kushtetutën “rast pas rasti” dhe të hedhë në kosh vendimet e veta të mëparshme sa herë që konstatimet, arsyetimet, përkufizimet dhe referencat e paraqitura në to nuk i vlejné për konstruktin artificial që ajo kërkon t’i japë çështjes së fundit që ka në dorë.

Gjykata është shprehur në mënyrë të përsëritur se aktet administrative nuk janë domen i saj. Për shembull, në vendimin e saj nr. 24, datë 23.3.2017, shkruhet se: *“Vendimi për shkarkimin nga detyra të organit të qeverisjes vendore është një akt individual i natyrës administrative. Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutbërësi, në mënyrë që t’u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115/2 të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t’u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ (shih vendimet nr. 67, datë 11.11.2016; nr.32, datë 10.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese)”*.

Në vendimin nr. 150, datë 16.6.2017, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese përcakton se: *“Kolegji konstaton se akti ndaj të cilit është ushtruar ankim, dekreti i Presidentit të Republikës, ... është një akt administrativ individual, pasi ka për objekt vetëm caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Për këtë arsye, Kolegji çmon se ky akt nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate, por në juridiksionin e Gjykatave Administrative, dhe për këtë arsye kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate me objektin sipas kërkesës”*.

Po kështu, Gjykata Kushtetuese ka saktësuar se Kryetari i shkarkuar i Bashkisë mund t’i drejtohet kësaj gjykate nëse ai shkarkohet nga Këshilli i Ministrave “për shkelje të ligjit”. Në vendimin nr. 24, datë 23.3.2017, Gjykata shprehet se: *“Nisur nga praktika e vazhdueshme e kësaj Gjykate, kërkuesi legjitimohet prima facia t’i drejtohet Gjykatës, nëse shkarkohet nga KM-ja për shkelje të ligjit, sipas nenit 115/2 të Kushtetutës”*. Shkarkimi për rrethana të tjera që nuk formojnë shkelje të ligjit nuk mund të angazhojë Gjykatën Kushtetuese. Konkretisht, mungesa e vazhdueshme për më shumë se tre muaj në detyrë nuk përbën shkelje të ligjit, por përbën mosushtrim të detyrës.

Duke marrë në analizë rastin e shkarkimit për shkak të veprimit të ligjit të dekriminalizimit, Gjykata Kushtetuese ka saktësuar në vendimin e saj nr. 24, datë 23.3.2017, se: ***“Në rastin konkret nuk ndodhemi para situatës së parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, sipas të cilit, kur në veprimtarinë e organit të zgjedhur drejtpërdrejt të njësisë së qeverisjes vendore konstatohen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve, ai mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga KM-ja”***. Më tej, Gjykata thekson se kur *“pretendimet e kërkuarit për kundërshtimin e vendimit të KM-së nuk bien në rrethin e çështjeve të parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës...nuk mund të shqyrtohen nga kjo Gjykatë”*.

Gjykata Kushtetuese ka një jurisprudencë të pasur rreth tematikës së rastit. Kjo jurisprudencë do ta kishte orientuar Gjykatën në çdo hap të saj në drejtimin e kundërt me rrugën që ka ndjekur. Insistimi i Gjykatës Kushtetuese, që vetëm në këtë rast të bënte të kundërtën, nuk shpjegohet dot me arsye që pranohen nga logjika.

II. LEGJITIMIMI, SI ÇËSHTJE THEMELI

1. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka marrë vendim të pranojë për shqyrtim kërkesën e Kryetarit të shkarkuar të Bashkisë Tiranë, domethënë ka legjitimuar kërkuarin dhe ka njohur kompetencën e saj mbi lëndën, përfshirë dekretin e Presidentit të Republikës nr. 350, datë 1.10.2025. Këtë vendim, mbledhja e Gjyqtarëve e ka marrë duke thirrur në konsultë vetëm kërkuarin dhe duke privuar nga një e drejtë thelbësore palët e interesuara. Aq e vërtetë është kjo, saqë Gjykata ka preferuar të vetizolohet ndaj argumenteve të kundërta të palëve të interesuara, të cilat ishin bërë publike dhe ishin të disponueshme nëpërmjet mjeteve të komunikimit përpara se mbledhja të merrte vendimin.
2. Çështja e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar kërkesën e Kryetarit të shkarkuar të Bashkisë Tiranë (legjitimimi *ratione materiae* plus legjitimimi *ratione personae*) është, në fakt, thelbi i konfliktit të ngritur përpara kësaj Gjykate, përbën lëndën e shqyrtimit në themel, të paktën për sa i takon dekretin të Presidentit të Republikës. Presidenti i Republikës, kur nxjerr dekretin për shpalljen e datës së zgjedhjeve, nuk mund të udhëhiqet nga një dispozitë e Kushtetutës, e cila nuk ka lidhje me rastin.
3. Debati lidhur me VKM-në nr. 539, datë 25.9.2025, qëndron, së pari, në diskutimin nëse shkarkimi në bazë të shkronjës “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 përfshihet në garancitë e nenit 115 të Kushtetutës apo është jashtë tyre. Diskutimi nëse rrethanat konkrete të Kryetarit të Bashkisë Tiranë përkrijnë me shkakun ligjor të shkarkimit, sipas shkronjës “c” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 mund të bëhet vetëm si hap i dytë vetëm pasi të jetë sqaruar hapi i parë dhe vetëm nga Gjykata që ka kompetencën ligjore për rastin.
4. Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për të dy këto komponentë themeli, duke përjashtuar palët e interesuara nga diskutimi i çështjes. Një procedim i tillë përbën jo vetëm rrethanë flagrante të cenimit të paanësisë së detyrueshme ligjore, por edhe cenim

të rëndë të procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese ka vendosur për një çështje themeli, pa dëgjuar palët dhe pa marrë në konsideratë argumentet e tyre.

5. Ky vendim i mbledhjes së Gjyqtarëve është antikushtetues dhe duhet të korrigohet menjëherë. Gjykata Kushtetuese duhet të riçelë diskutimin për legjitimitimin dhe të rivendosë për të pasi të ketë dëgjuar edhe argumentet e palëve të interesuara përpara se të procedojë me çdo hap tjetër.

III. LEGJITIMIMI SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

1. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar gjithmonë nga Gjykata Kushtetuese si një çështje thelbësore për nisjen e një procesi kushtetues. Kërkuesi duhet të demonstrojë përpara Gjykatës se:
 - (i) është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe të provojë interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (legjitimimi *ratione personae*);
 - (ii) ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 15-ditor nga nxjerrja e aktit të shkarkimit (legjitimimi *ratione temporis*);
 - (iii) provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra e drejta që pretendohen se është cenuar është e garantuar nga Kushtetuta, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (legjitimimi *ratione materiae*).
2. Kushtetuta mbron Kryetarin e Bashkisë, si organ i zgjedhur i qeverisjes vendore, nga shkarkimi në rastin kur Këshilli i Ministrave vendos shkarkimin e tij “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”. Kjo mbrojtje nuk është mbrojtje e përgjithshme, nuk vepron për çdo shkarkim. Ajo vepron vetëm për shkarkimin “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve” (shkronja “a” e nenit 62 të ligjit nr. 139/2015). Për të gjitha rastet e tjera të shkarkimeve, mjetet mbrojtëse janë të tjera.
3. Shkarkimi për efekt të ligjit të dekriminalizimit kryhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, (neni 8 i ligjit nr. 138/2015), ankimimi administrativ bëhet në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, (shkronja “b” e pikës 1 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor), kurse ankimimi gjyqësor bëhet në Gjykatën Administrative, (shkronja “a” e pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012).
4. Shkarkimi për efekt të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 62 të ligjit nr.139/2015 bëhet nga Këshilli i Ministrave dhe ankimimi gjyqësor bëhet në Gjykatën Administrative, (shkronja “a” e pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012).
5. Neni 115 i Kushtetutës formon garanci për organet e zgjedhura të qeverisjes vendore, sepse shkakun e shkarkimit, shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, ia nënshtron verifikimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Është kjo e fundit, e cila ka detyrën të

përcaktojë nëse në rastin e shkarkimit ka vërtet shkelje të Kushtetutës ose të ligjeve dhe nëse këto shkelje janë vërtet të rënda. Në të gjitha rastet e tjera të shkarkimit, Gjykata Kushtetuese nuk ka se çfarë të verifikojë. Të gjitha rastet e tjera të shkarkimit nuk kanë lidhje me shkelje të Kushtetutës ose të ligjeve, prandaj dhe ajo nuk mund të angazhohet me shqyrtimin e çështjes.

6. Shkarkimi, për çfarëdo lloj shkaku, nuk ka lidhje me faktin se Kryetari i Bashkisë është person i zgjedhur nga populli. Zgjedhja nga populli nuk përcakton juridiksionin kushtetues. Juridiksionin kushtetues e përcakton vetëm shkaku kushtetues për shkarkimin, “shkelja e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve”. Pretendimi i kërkuarit që kërkon ta lidhë juridiksionin kushtetues me zgjedhjen dhe jo me shkarkimin nuk i qëndron dot jo vetëm analizës semantike të dispozitës, por edhe asaj sistematike.
7. Nëse Gjykata Kushtetuese do të ishte Gjykatë kompetente për të gjitha rastet e shkarkimit të personave të zgjedhur, atëherë kjo kompetencë do të ishte listuar në kompetencat e parashikuara nga neni 131 i Kushtetutës.
8. Ky nen e ka dispozitën që njeh të drejtën ekskluzive të Gjykatës Kushtetuese për shkarkimin e funksionarëve të lartë (shkronja “dh” e nenit 131). Në këtë dispozitë nuk bën pjesë Kryetari i Bashkisë. Dispozita e shkronjës “dh”, është dispozitë që akordon mbrojtje të përgjithshme. Çdo President në detyrë mund të shkarkohet vetëm “për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë”, (pika 2 e nenit 90). Mjafton të bëhet ky krahasim dispozitash dhe dallimi me Kryetarin e Bashkisë bëhet krejtësisht i qartë dhe nuk lë vend për asnjë mëdyshje. Mbrojtja e nenit 115 nuk është mbrojtje e përgjithshme. Ajo nuk vepron për çdo shkak ligjor shkarkimi, por vetëm për shkarkimin për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve. Në rast se Kryetari i Bashkisë do të shkarkohej vetëm për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe juridiksioni në çdo rast do t’i takonte Gjykatës Kushtetuese, atëherë Kryetari i Bashkisë do të ishte vendosur në listë me Presidentin e Republikës në nenin 131 të Kushtetutës.
9. Po kështu, Kushtetuta nuk parashikon juridiksion të përgjithshëm kushtetues për asnjë nga subjektet e tjera të zgjedhura nga populli. Neni 131 i saj njeh kompetencën e Gjykatës Kushtetuese vetëm për *“çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre”*. Pra, vetëm *“zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë”*.
10. Gjykata Kushtetuese vihet në veprim sipas nenit 115 të Kushtetutës, si garant i sistemit kushtetues dhe si barrierë që nuk lejon abuzimin e pushtetit ekzekutiv me tagrat e tij të pushtetit. “Shkelja e rëndë e Kushtetutës dhe e ligjeve” është një shkak juridik që duhet t’i nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese përpara se shkarkimi të ketë efekt. Kjo është mbrojtja që akordon Kushtetuta. Nëse shkarkimi nuk bëhet për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, atëherë Gjykata Kushtetuese nuk ka çfarë të shqyrtojë dhe nuk ka çfarë të mbrojë. Pretendimi se shkaku tjetër i shkarkimit, duke qenë i pavërtetë ose i paligjshëm, mund të ketë cenuar gjithsesi të drejtat kushtetuese të Kryetarit të

shkarkuar të Bashkisë, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor administrativ dhe mund të vijë në Gjykatën Kushtetuese vetëm në kuadër të gjykimit incidental, ose vetëm pas ezaurimit të iterit procesual gjyqësor.

11. Këto rregulla bazë kushtetuese dhe ligjore janë të vlefshme si për individët, ashtu edhe për organet publike. Kompetenca për shqyrtimin e çfarëdolloj mosmarrëveshjeje i përket për të dyja palët juridiksionit të rregullt gjyqësor. Kryetari i shkarkuar i Bashkisë mund t'i drejtohet përjashtimisht Gjykatës Kushtetuese vetëm kur shkarkohet “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”. Ai nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese as në bazë të shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës, sepse shkarkimi nga Këshilli i Ministrave nuk është mosmarrëveshje kompetence.
12. Për sa më sipër, demonstroi se kërkuesi nuk mund të legjitimohet *ratione personae*, sepse ai nuk është shkarkuar nga Këshilli i Ministrave “për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve”. E drejta kushtetuese që buron nga neni 115 i Kushtetutës nuk është cenuar në këtë rast.
13. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae* duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese i merr kompetencat e saj nga Kushtetuta. Në rrethin e saj të kompetencave bën pjesë shqyrtimi i kërkesave për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, (shkronja “a” e nenit 131), papajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre, (shkronja “b” e nenit 131), papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, (shkronja “c” e nenit 131). Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë të shqyrtojë papajtueshmërinë e akteve administrative me Kushtetutën, përveç rastit të përcaktuar në nenin 115 të Kushtetutës, kur me akt administrativ individual bëhet shkarkimi i organit të zgjedhur të qeverisjes vendore “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”.
14. Kodi i Procedurave Administrative është ligji që klasifikon aktet administrative. Në pikën 1 të nenit 3 të tij përcaktohet ky klasifikim:
 - “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
 - “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
 - “Akti i garancisë” është një akt administrativ individual, me anë të të cilit organi publik, nëse kjo parashikohet me ligj të veçantë, mund të sigurojë paraprakisht se

ai do të nxjerrë ose nuk do të nxjerrë një akt të caktuar administrativ individual në një datë të mëvonshme.

15. Aktet administrative individuale kanë karakteristikë thelbësore faktin se ato i drejtohen një apo disa subjekteve specifike konkrete (individ, person fizik apo person juridik). Në rastin kur subjekti apo subjektet, të cilëve i drejtohet akti, janë të përcaktuara individualisht, atëherë akti është akt administrativ individual (element i domosdoshëm për ta dalluar nga akti administrativ kolektiv). Po kështu, edhe marrëdhënia juridike që krijon, ndryshon ose shuan akti administrativ individual duhet të jetë marrëdhënie juridike specifike konkrete (element i domosdoshëm për ta dalluar nga kontrata administrative dhe veprimet e tjera administrative).
16. Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i përpunuar nga SIGMA në vitin 2018, në faqet 18-21 të përkthimit shqip, bën të qarta jo vetëm karakteristikat dalluese të akteve administrative individuale, por bën edhe klasifikimin e tyre sipas llojit të pasojës juridike që prodhon akti. Sipas këtij komentari, i cili është materiali i vetëm referues i kësaj natyre për Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, aktet administrative që konfirmojnë me efekt ligjor detyrues ekzistencën e një situatë ligjore, (për shembull: emërimin, shkarkimin, ose daljen në pension të një nëpunësi civil), janë akte deklarative.
17. Pra, legjislacioni në fuqi përcakton qartësisht se VKM-ja nr. 539, datë 25.9.2025, është akt administrativ individual dhe dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 350, datë 1.10.2025, është akt administrativ kolektiv.

“Aktet normative” që përmend Kushtetuta përfshihen nga KPrA në kategorinë “akt normativ nënligjor” dhe përkufizohen si më poshtë:

- *“Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij (Neni 3, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative).*
18. Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion mbi dekretin nr. 350, datë 1.10.2025. Juridiksionin (*ratione materiae*) e përcakton natyra e aktit objekt shqyrtimi, jo efektet që shkakton ai. Gjykata Kushtetuese ka pranuar të shqyrtojë një akt administrativ, mbi të cilin nuk ka juridiksion, për shkak se nuk ka ditur si të pengonte veprimin e tij. Ky është arbitraritet i patolerueshëm për një sistem që vepron mbështetur në parimet e shtetit ligjor.
 19. Gjykata Kushtetuese duhet të deklarojë menjëherë mungesën e kompetencës për shqyrtimin e dekretit nr. 350, datë 1.10.2025, të heqë menjëherë pezullimin që ka vendosur mbi dekretin dhe të çlirojë Institucionin e Presidentit të Republikës nga statusi i palës së interesuar, sepse dekreti i Presidentit të Republikës nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në këtë çështje. Përndryshe, procedura mund të kryhet deri në fund, por do të jetë deri në fund antikushtetuese.

20. Sikurse u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese nuk mund të ketë juridiksion as mbi vendimin nr. 539, datë 25.9.2025, sepse Kushtetuta i njeh asaj vetëm të drejtën që të mbrojë organin e zgjedhur të qeverisjes vendore kur shkarkimi i tij bëhet “për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”, por kjo është një kauzë që i takon palës tjetër të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ta mbrojë. Prandaj Institucioni i Presidentit të Republikës nuk mund të ndalet më gjatë rreth argumenteve në këtë drejtim.

IV. KONKLUZION

Institucioni i Presidentit të Republikës, në cilësinë e palës së interesuar, i kërkon Gjykatës Kushtetuese:

1. Të deklarojë në fillim të seancës së shqyrtimit të datës 31.10.2025 moskompetencën lidhur me dekretin nr. 350, datë 1.10.2025;
2. Të vendosë në fillim të seancës së shqyrtimit të datës 31.10.2025 heqjen e pezullimit për dekretin nr. 350, datë 1.10.2025;
3. Të vendosë në përfundim të seancës rrëzimin e kërkesës së Kryetarit të shkarkuar të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, si të pabazuar në nenin 115 të Kushtetutës;
4. Për shkak se pezullimi ka pamundësuar zhvillimin e zgjedhjeve për Bashkinë Tiranë në datën e dekretuar nga Presidenti i Republikës, të urdhërojë në përfundim të seancës KQZ-në për përgatitjen e zgjedhjeve për këtë bashki në datën që do të përcaktojë Gjykata Kushtetuese, datë e cila nuk duhet të jetë më e hershme se 30 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në vlerësimin tonë si palë e interesuar, vetëm një procedim i tillë mund të rikthejë kushtetutshmërinë e këtij procesi ankimor, të cenuar në mënyrë arbitrare nga vetë Gjykata Kushtetuese.